

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit S. K. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamentit të Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.2416/2014 të datës 06.11.2014, pas mbajtjes së seancës fillestare në praninë e Prokurorit të Shtetit në Prizren Mehreme Hoxha dhe të akuzuarit, me datë 27.08.2015 publikisht morri dhe shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari:

**S. K.** nga i ati S. dhe e ëma L. e lindur K., i lindur më datën “data e lindjes..” në Prizren ku edhe tani jeton rruga “..... ....” ... , ka të kryer shkollën e mesme, rrobaqepës, i martuar, baba i katër fëmijëve, me numër personal ....., i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

Prej datës së pavërtetuar e deri më datën 03.07.2014, në Prizren në rrugën “..... ....” ... , në shtëpinë e tij familjare, merr, përdor, devijon, nxjerrë ose përfiton nga ndonjë shërbim komunal që furnizohet përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që pas kontrollimit nga ana e ekipit të specializuar të KEDS – Distribucioni në Prizren dhe pas kontrollimit të pikës matëse, i akuzuari bën shfrytëzimin energjisë elektrike me njehsori i cili dy pllombat shtetërore i ka të falsifikuara, në brendi numëruesi i njehsorit është i manipuluar ka gjurmë të gërvishtjes së numrit në numëror, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me të cilat veprime të dëmtuarës KEDS – Distribucioni në Prizren i shkakton dëm material në shumën prej 170.38 €.

#### **Kësodore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK.**

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 320 të KPK i shqipton dënimet dhe atë:

### DËNIM ME KUSHT

Ashtu që vërteton

- dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afati prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

- dënimin me gjobë në lartësi prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro) i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afati prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

E dëmtuara KEDS – Distribucioni në Prizren në përmjet autorizuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

I akuzuari obligohet të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 € në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.2416/2014 të datës 06.11.2014, kundër të akzuarit S. K. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK.

Prokurori i Shtetit Mehreme Hoxha, që në fillim të seancës fillestare bëri përmirësimin dispozitiv të aktakuzës dhe atë duke filluar nga rreshti i dytë në vend të fjalëve “ndryshon njehsorin që përdoret për matjen e sasisë së ndonjë shërbimi komunal, me të cilën është furnizuar cili do objekt nga furnizuesi i autorizuar” duhet të qëndrojnë fjalët “të përdor, devijon, nxjerrë ose përfiton nga ndonjë shërbim komunal që furnizohet përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar”, me këtë rast ka bërë edhe rikualifikimin e veprës penale nga “ndryshimi i njehsorit të shërbimeve nga neni 323 par.1 të KPK, në veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK”.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e Prokurorit të Shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akzuarit. I akuzuari pas kësaj deklaroi se ka kuptuar aktakuzën dhe nuk e kundërshton provat materiale.

Gjykata në seancën fillestare ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike në datë 03.07.2014, në Prizren, i akuzuari S. K. në shtëpinë e tij familjare, me shifër të konsumatorit .... , me numër të njehsorit elektrik ..... , pas një kontrolli nga ana e zyrtarëve të KEDS – Distribucioni në Prizren, është vërtetuar se i akuzuari merr, përdor dhe përfiton nga shërbimi komunal që në mënyrë të paautorizuar e ka shfrytëzuar energjinë elektrike, që të dy pllombat shtetërore i ka të falsifikuara, në brendi numëruesi i njehsorit është i manipuluar ka gjurmë të gërvishtjes së numrit në numëror, ashtu që energjia e harxhuar nuk është regjistruar, me ç’rast të dëmtuarës KEDS – Distribucioni në Prizren i shkakton dëm material në vlerë prej 170.38 €. Me këto veprime i akuzuari ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar nga pranimi vullnetar i fajësisë nga ana e akzuarit për veprimet e tija të përshkruara si në përshkrimin faktik të aktakuzës. Gjykata nuk ka administruar provat, pasi që nuk ekzistoi ndonjë provë e papranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale me të cilën ngarkohet dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht. Vlen të theksohet se pranimi i fajit është mbështetur në fakte që përmban aktakuza me ç’rast i akuzuari prej fillimit të procedurës ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat asnjëherë nuk i ka kundërshtuar. Po ashtu gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e akzuarit

është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 246 të KPPK dhe ka ardhur në përfundim se në veprimet e tij formohen të gjitha elementet e qenësore të veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese morri parasysh faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunim me organet e drejtësisë, sjellja korrekte gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi për kryerjen e veprës penale, është mbajtës i familjes shumë anëtarësh, është i gjendjes së dobët ekonomike, gjer më tani nuk ka kryer vepër penale, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoj dënimet si në shqiptim të këtij aktgjykimi duke menduar se dënimet e shqiptuar i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e këtilla, me bindje se janë proporcionale me peshën e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarës në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.1721/2014 të datës 27.08.2015**

**Procesmbajtësja**  
**Myrvete Përdibuka**

**Gjyqtarja**  
**Teuta Krusha**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.